

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR IDENTITY SHPK

Në këtë statut:

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", i ndryshuar;
- "Statuti" është Statuti i shoqërisë;

KREU I THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

NENI 1 DATA E THEMELIMIT, EMRI DHE THEMELUESIT

1. Sot, më 31/08/2021, unë, themeluesi Tom Therçaj me Nr. ID Personal F80908028U, në cilësinë e Ortakut të Vetëm, kam krijuar Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar me emërtimin tregtar "IDENTITY".
2. Themeluesi i shoqërisë është:

Z. Tom THERÇAJ, lindur në Kastrat, më datë 08/09/1958, dhe banues në Tiranë në adresën Rruga Gjik Kuçali, Nd.2 H.12 Ap.5, 1019 Tiranë, Shqipëri, me Nr. ID Personal F80908028U.

NENI 2 OBJEKTI

1. Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Ideim, konceptim, dizenjim, krijim, prodhim dhe tregtim të strategjive, mjeteve, shërbimeve dhe produkteve për Administrim dhe Menaxhim, Marketing dhe Zhvillim Biznesi, Veprimtari dhe Aktivitete, Produksion dhe Distribucion Mediatik, Teknologji dhe Informacion, Kërkim dhe Zhvillim Shkence, Art dhe Kulturë, Sport dhe Edukim, Pasuri të Paluajtshme dhe të Luajtshme, etj., të të gjitha llojeve dhe formave ligjore, në dobi të organizatave publike dhe entiteteve të pavarura shtetërore, Organizatave Publike dhe Organizatave Jo-Fitimprurëse, Personave Individ, Personave Juridik dhe Personave Fizik, Organizatave dhe Individëve Ndërkombëtarë dhe Shqiptarë të regjistruar tatimpagues dhe jo-tatimpagues, rezident dhe jo-rezident, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë; Shërbime ndërmjetsimi dhe konsulencë për administrim, mirëmbajtje, blerje, shitje dhe dhënie me qera të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme, komplekseve të banimit dhe të tregtisë së lirë të produkteve dhe shërbimeve, blloqeve rezidenciale dhe të bizneseve, etj., për organizata, sipërmarrje dhe individë; Ideim, konceptim, dizenjim, krijim, prodhim dhe tregtim të strategjive, mjeteve dhe produkteve për ideim, organizim, zhvillim dhe menaxhim të aktiviteteve, panairove, koncerteve dhe të gjithë llojeve të veprimtarive dhe eventeve publike dhe private, sociale, ndërgjegjësuëse, promovuese, argëtuese, edukative, kulturore, artistike, sportive, konkurruese, etj.; Ideim, konceptim, dizenjim, krijim, prodhim dhe tregtim të strategjive, mjeteve dhe produkteve, si dhe zhvillim i projekteve të përshtatshme për mobilim, dekorim dhe strukturim të ambienteve të banimit, ushtrimit të biznesit, veprimtarive dhe çfarëdo tjetër përputhet me fushën e veprimtarisë së shoqërisë, etj., brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë; Çfarëdo shërbimi tjetër që ekziston aktualisht në tregjet ekonomike dhe industrinë e përparuara ndërkombëtare globalisht, si dhe shërbimet e produktet që mund të sjellin kurdoherë në vazhdim përparimi dhe zhvillimi shkencor, teknologjik, akademik e kërkimor në sektorët global dhe universal të ekonomisë dhe industrinë Administrim dhe Menaxhim, Marketing dhe Zhvillim Biznesi, Veprimtari dhe Aktivitete, Produksion dhe Distribucion Mediatik, Teknologji dhe Informacion, Kërkim dhe Zhvillim Shkence, Art dhe Kulturë, Sport dhe Edukim, Pasuri të Paluajtshme dhe të Luajtshme, etj., të të gjitha llojeve dhe formave

ligjore, në dobi të organizatave publike dhe entiteteve të pavarura shtetërore, Organizatave Publike dhe Organizatave Jo-Fitimprurëse, Personave Individ, Personave Juridik dhe Personave Fizik, Organizatave dhe Individëve Ndërkombëtarë dhe Shqiptarë të regjistruar tatimpagues dhe jo-tatimpagues, rezident dhe jo-rezident, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë; Shërbime dhe ekspertizë profesionale të specializuara në të gjithë sektorët e ekonomisë dhe industrisë, Administrim dhe Menaxhim, Marketing dhe Zhvillim Biznesi, Veprimtari dhe Aktivitete, Produksion dhe Distribucion Mediatik, Teknologji dhe Informacion, Kërkim dhe Zhvillim Shkence, Art dhe Kulturë, Sport dhe Edukim, Pasuri të Paluajtshme dhe të Luajtshme, etj., të të gjitha llojeve dhe formave ligjore, në dobi të organizatave publike dhe entiteteve të pavarura shtetërore, Organizatave Publike dhe Organizatave Jo-Fitimprurëse, Personave Individ, Personave Juridik dhe Personave Fizik, Organizatave dhe Individëve Ndërkombëtarë dhe Shqiptarë të regjistruar tatimpagues dhe jo-tatimpagues, rezident dhe jo-rezident, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë; Konsulencë dhe sipërmarrje e specializuar në fushën e menaxhimit, marketingut, marrëdhënieve me publikun, medias, zhvillimit të biznesit, teknologjisë, informacionit tradicional dhe dixhital, kërkimit, zhvillimit shkencor dhe edukativ, trashëgimisë kulturore, artit dhe sportit, edukimit të brezave, kërkimeve shkencore dhe zhvillimeve akademike, investimeve, pasurive të paluajtshme, etj. për organizata, entitete, biznese dhe individë, ndërkombëtarë dhe vendas, në formë tradicionale (fizikisht) ose dixhitale (online); Realizim profesional të prodhimeve të shumëllojshme mediatike tradicionale dhe dixhitale (shtypi, audiovizive), si për shembull (por pa u limituar në to) ideim, konceptim, dizenjim, krijim, prodhim e redaktim, të artikujve, skenareve, filmave me metrazh të shkurtër e të gjatë, dokumentarëve, reportazheve, emisioneve audiovizive radiofonike dhe televizive të të gjitha llojeve në të gjitha llojet e medias, produkteve audiovizive për të tretët për t'u përdorur në lajme, kronika, materiale informuese, etj., reklama, revista, botime të ndryshme, broshura, fushata promovuese, informuese dhe ndërgjegjësuese për publikun, etj., faqe interneti website, platforma për tregtim produktesh dhe shërbimesh online, rrjete komunikimi dhe sisteme menaxhimi të biznesit dhe klientëve, sisteme monitorimi dhe sigurie dixhitale, konfigurime dhe mirëmbajtje të rrjeteve të avancuara të teknologjisë së komunikimit dhe informacionit, etj., zhvillim dhe menaxhim i strategjive të marketingut tradicional dhe dixhital në platformat e përshtatshme moderne ndërkombëtare, kërkim tregu dhe studim sjellje konsumatore, etj., në forma tradicionale dhe dixhitale të pranuar dhe zbatuara aktualisht, si dhe ato që mund të vijnë si rezultat i zhvillimeve shkencore, teknologjike dhe akademike në vazhdim.

NENI 3 KOHËZGJATJA

1. Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë:

Kohëzgjatje e papërcaktuar.

NENI 4 SELIA

1. Selia e shoqërisë ndodhet në adresën:

Tirane Tirane TIRANE Rruga Sami Frasheri, Hyrja 1, Apartamenti 23, Nr. Pasurie 2/145+1-23, Zona Kadastrale Nr. 8270

2. Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon:

tomthercaj@hotmail.com

**KREU II
KAPITALI**



NENI 5
KAPITALI THEMELTAR

1. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000,00 (njëqind mijë) Lek. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

Ortaku themelues:

- Z. Tom THERÇAJ – Zotërues i 1 (një) kuotave me vlerë të përgjithshme 100.000,00 (njëqind mijë) Lek, që përbën 100% (njëqind për qind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

NENI 6
ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

1. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
2. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
3. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
4. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

NENI 7
TRANSFERIMI I KAPITALIT

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë
 - b) shitblerjes
 - c) trashëgimisë
 - d) dhurimit
 - e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj
2. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

NENI 8
ORGANI VENDIMMARRËS

1. Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë. Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
2. Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë
- b) ndryshimet e statutit



- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve
 - d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar
 - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike
 - a) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
 - b) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - c) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit
 - d) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve
 - f) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
 - g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë
 - h) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti
3. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

NENI 9

MËNYRA E THIRRJES SE MBLEDHJES SE ASAMBLESË SE PËRGJITHSHME

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë pune përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 10

KUORUMI

1. Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
2. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
3. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 11

MARRJA E VENDIMEVE

1. Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar
- d) përcaktimin e shpërblimeve



- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresisë së veprimtarisë
 - f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve
 - g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë
3. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

NENI 12 PËRJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTËS

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria
 - d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.


NENI 13 ADMINISTRIMI

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
2. Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit:


Tom THERÇAJ
Adresa: Rr. Gjik Kuqali, Nd.2 H.12 Ap.5,
1019 Tiranë, Shqipëri
Cel. +355692088303
E-mail: tomthercaj@hotmail.com

Specimenët e nënshkrimit:



NENI 14 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE

1. Administratorët kanë të drejtë dhe detyrohen të:
- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme
 - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare
 - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë
 - d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecuresisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim
 - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë
 - f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit



- g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare
 - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut
2. Administratoret janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:
- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
 - c) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
3. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
4. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 15 PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATORIT

- 1. Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- 2. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- 3. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:
 - a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim
 - d) të parandalojë dhe mënjanë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë
 - e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm
- 4. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 5. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

6. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
- u kthen ortakëve kontributet
 - u paguan ortakëve interesa apo dividendë
 - u shpërndan aktivet shoqërisë
 - lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet
 - jep kredi
7. Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit
8. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV VITI FINANCIAR – EKSPERTËT

NENI 16 VITI FINANCIAR

- Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

NENI 17 EKSPERTËT

- Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tille i ngarkuar nga ana e ortakëve.
- Ne përfundim të kontrollit, eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ua paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

KREU V PRISHJA – RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

NENI 18 PRISHJA DHE LIKUIDIMI

- Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohë:
 - kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj
 - me vendim të Asamblesë së Ortakëve
 - me hapjen e procedurave të falimentimit
 - nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"
 - me vendim të gjykatës

2. Ne këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 (një) apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese "Shoqëri në likuidim e sipër".
3. Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
4. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.
5. Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

NENI 19
RIORGANIZIMI I SHOQËRISË, BASHKIMI - NDARJA

1. Shoqëria mund të ndahet/bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

NENI 20
BAZA LIGJORE

1. Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi, vlerat njerëzore dhe morale, integritetin dhe parimet solidare.
2. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, zbatohen ekskluzivisht dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe ligjet përkatëse në Republikën e Shqipërisë.

NENI 21
MOSMARRËVESHJET

1. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

O R T A K Ë T
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
IDENTITY SHPK

